

VENDIM
Nr. 737, datë 17.9.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT
KOMBËTAR TË KUJDESIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim Fondi).

2. Burimet e financimit të Fondit janë:

a) të ardhurat e krijuara nga vendet e artit e të kulturës, në kuptim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe muzetë;

b) të ardhurat dytësore të krijuara nga ofrimi i shërbimeve dhe përdorimi i pasurive kulturore në administrim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ose institucioneve të specializuara në varësi të saj dhe në administrim të institucioneve në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe të muzeve publike;

c) financime vendase apo të huaja për këtë qëllim, të cilat burojnë në mënyrë të ligjshme nga organizata publike, private ose persona fizikë, të përfituara në formën e donacioneve ose të sponsorizimeve;

ç) buxheti i shtetit;

d) të ardhurat e gjeneruara nga kundërvajtjet administrative në masën 90%.

3. Të ardhurat e Fondit përdoren për mbështetjen e politikës kombëtare për ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore materiale, në drejtimet kryesore, si më poshtë vijon:

a) kryerjen e ndërhyrjeve emergjente për konsolidimin, konservimin dhe restaurimin e pasurive kulturore;

b) realizimin e projekteve për zhvillimin, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, rijetëzimin e pasurive kulturore dhe/ose përmes granteve apo instrumenteve të tjera të financimit;

c) realizimin e studimeve, dokumentimin në kuadër të mbrojtjes, të ruajtjes dhe të rehabilitimit të trashëgimisë kulturore materiale, siç përcaktohet në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe hartimin e projekteve për mbrojtjen, konservimin, restaurimin e pasurive kulturore;

ç) zhvillimin e projekteve kulturore, me qëllim promovimin e trashëgimisë kulturore materiale;

d) trajnimin e stafit dhe të specialistëve, në të gjitha nivelet, në fushën e identifikimit, të mbrojtjes, të ruajtjes dhe të rehabilitimit të trashëgimisë kulturore materiale;

dh) zhvillimin e aktiviteteve të tjera të trashëgimisë kulturore, me miratimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

4. Mënyra e përdorimit të të ardhurave, sipas burimit të krijimit të tyre, realizohet, si më poshtë vijon:

a) të ardhurat e krijuara sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, përdoren në përputhje me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

b) të ardhurat e krijuara sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të këtij vendimi, përdoren në përputhje me marrëveshjet përkatëse, ndërmjet institucionit dhe subjektit, personit juridik, publik ose privat, vendas apo të huaj.

c) të ardhurat e krijuara sipas shkronjave “ç” dhe “d”, të pikës 2, të këtij vendimi, përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin buxhetor e financiar.

5. Administrimi i të ardhurave të Fondit menaxhohet nga struktura kompetente pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore (në vijim struktura).

6. Administrimi i llogarive të Fondit bëhet në përputhje me legjislacionin financiar të kontabilitetit dhe të raportimit financiar të parashikuar për institucionet publike.

7. Struktura kryen këto funksione:

a) përgatit dhe harton planifikimin strategjik dhe orientimet vjetore të përdorimit të Fondit, për qëllimet e përcaktuara nga ligji;

b) monitoron zbatimin e projekteve të financuara nga Fondi;

c) harton raportet financiare dhe administron programin financiar të Fondit, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm;

ç) mbledh të dhëna, harton statistika dhe informacione të lidhura me përdorimin e Fondit;

d) harton raportin vjetor për përdorimin e Fondit, në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse për buxhetin, pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

dh) harton procedurat e aplikimit dhe kriteret e vlerësimit për administrimin e Fondit, mbi bazën e programit dhe të llojit të financimit;

e) harton dokumentacionin e nevojshëm, kontratën e lidhur me përfituesin e projektit.

8. Të ardhurat e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, përfshihen në të ardhura jashtë limitit, që mbarten në vitin buxhetor pasardhës. Këto të ardhura mbulojnë nevojat dhe aktivitetet e institucioneve sipas ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

9. Ngarkohen ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe ministria përgjegjëse për financat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama